

Qiradhënia e Sallës së Recitalit studio **“Ionesco”**

Rezervimet për qiradhënien e studio “Ionesco” duhet të bëhen të paktën 2 javë përpara. Rezervimet mund të bëhen deri në katër muaj përpara. Pagesa duhet të bëhet minimalisht 7 ditë përpara eventit.

Të gjitha kërkesat për rezervim duhet të shkruajnë një email tek info@akademiahollywood.com ku të shkruani emrin tuaj, numrin e telefonit si dhe datën apo datat që dëshironi të rezervoni.

Rezervimet mund të jenë 2, 3 orëshe, ose gjysëm dite.

Rezervimet mund të bëhen të premteve, të shtunë dhe të dielë*.

Rezervimet dy orëshe:

(6500 lekë total)

Eventi A: 09:30 - 11:30

Eventi B: 12:00 - 14:00

Eventi C: 16:15 - 18:15

Eventi D: 18:30 - 20:30

Rezervime tre-orëshe:

(9000 lekë total)

Eventi E: 10:00 - 13:00

Eventi F: 17:30 - 20:30

Rezervime gjysëm dite, 4.5 orë

(11000 lekë total)

Paradite (09:00 - 13:30)

Pasdite (16:00 - 20:30)

Anullimet apo ndryshimi i datës

Pasi të jetë bërë rezervimi, nuk mund të jepen rimbursime, por mund të ndryshoni ditën e koncertit. Për ndryshimin e datës së koncerti, aplikohet një pagesë prej 2000 lekësh. Nëse e anuloni brenda ditës, pagesa është e pakthyeshme.

Rregullat e studio “Ionesco”

Studio “Ionesco” do të jetë e hapur në orarin që ju e keni prenotuar. (p.sh.: nëse eventit juaj fillon në 09:00 paradite, dyert do të hapen në 09:00 paradite dhe studio duhet të jetë e lirë në 11:00)

Ju lutem sigurohuni që të lajmëroni mësuesit, studentët, prindërit, të ftuarit dhe çdo pjesëmarrës tjetër për orarin e saktë se kur mund të jenë në studio.

Koha juaj e rezervuar duhet të përfshijë kohë të mjaftueshme për përgatitje, ngrohje dhe pastrim.

Piano

Salla e recitalit ka një piano me bisht Baby Grand “Yamaha”.

Vini re se piano duhet të mbetet në skenë. Nëse doni të ndryshoni pozicionin e pianos, ju lutem na kontaktoni pasi këtë mund ta bëjë vetëm stafi i studios “Ionesco”.

Kujdesuni kur hapni dhe mbyllni kapakun e pianos që të mos dëmtohet ose gërvishtet sipërfaqja.

Për çdo dëm në piano, tela, taste dhe stol duhet të paguani.

Karriget

Karriget do të rregullohen nga stafi i studio “Ionesco” për të qenë përballë skenës. Rregullimi standard do të jetë 28-30 karrige në stil “teatri” me një korridor në mes, përveç nëse keni specifika të tjera.

Studio nuk është e disponueshme për pritje. Në varësi të motit, pritjet mund të mbahen jashtë. Dy tavolina për freskuese mund të vihen në dispozicion me kërkesë nëse do të jetë ditë me mot të mirë.

Udhëzime për përdorimin e studio “Ionescos”

Nuk lejohen ushqime ose pije në studio “Ionesco”.

Gozhda, thumbat, kapëset, shirit ngjitës ose çdo send tjetër që mund të bëjë vrima ose të heqë bojën nga muret, dyert janë të ndaluara.

Organizatori duhet të marrë të gjitha sendet personale pas largimit (programe, partitura, veshje, etj). Organizatorët do të faturohen për çdo pastrim të jashtëzakonshëm të nevojshëm pas përdorimit.

Çdo dëm në objekt (p.sh. mure, dyer, tavolina, karrige, dysHEME ose piano) përtej konsumimit normal do t'i faturohet organizatorit ku ka ndodhur dëmi.

Sjellja e zhurmshme dhe e çrregullt është e ndaluar brenda studios në çdo kohë.

Ju lutemi sigurohuni që eventit juaj të mbetet i qetë dhe i sjellshëm.

Të rriturit duhet të mbikëqyrin fëmijët në çdo kohë.

Të tjera

Nëse për koncertet tuaja keni nevojë për regjistrim audio, instrumenta apo mikrofona me qera mund të na kontaktoni dhe t'ju nisim listën me tarifatat përkatëse.

Pyetje?

Kontaktoni me sekretarinë në **069 22 11158**